



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Cooperation for Development
and Cooperation SDC



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE

United Nations
ALBANIA




TË RINJTË BASHKIA E PËRMETIT



Qershor 2018



Leave
No One
Behind



Autor:

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve



© Aplikimet për leje për të shumëfishuar ose përkthyer pjesë nga ky Publikim duhet të dërgohen në:

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve

Rr. "Blv. Bajram Curri" Nd. 136, H. 14, Ap. 1

Njësia Administrative Nr 5, 1019, Tiranë, Shqipëri

Tel: 00355 42 258 987

Email: info@observator.org.al

Webmail: www.observator.org.al

Ky Publikim është realizuar nga UNFPA me ekspertizën e Observatorit për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve, në kuadër të projektit "Leave No One Behind" ("Askush të mos Mbetet Pas"), një Program i përbashkët i OKB-së i financuar nga Swiss Agency for Development and Cooperation (SDC) dhe zbatuar nga katër agjensi të OKB: UNDP, UNFPA, UNICEF, dhe UN WOMEN në partneritet me Qeverinë Shqiptare. Ky projekt synon fuqizimin e personave vulnerabël në Shqipëri që të kenë akses të barabartë në shërbimet dhe mundësitë publike, të kenë një zë në vendimmarrjen publike, që ndikon në jetën e tyre dhe t'i kërkojnë llogari zyrtarëve publikë, duke i mbajtur përgjegjës për dështimet apo arritjet.

Përmbajtja e këtij Publikimi është përgjegjësi e Observatorit për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve, në emër të rrjetit të organizatave "Zëri i të rinjve". Opinione të shprehura këtu janë të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht opinionet e UNFPA-së, UN Albania apo SDC.

Në periudhën Prill - Maj 2018 janë anketuar 100 të rinj nga Bashkia e Përmetit me qëllim matjen e njohurive të tyre mbi:

- a. Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs)
- b. Shëndetin Seksual dhe Riprodhues
- c. Programet dhe shërbimet e Bashkisë për të rinjtë

PROFILI I TË RINJVE TË ANKETUAR:

• **Grupmosha:** 14 - 29 vjeç


• **Vendndodhja:**

68 % nga zonat urbane

- Shkolla 9 vjeçare "Meleq Gosnishti"
- Shkolla 9 vjeçare "Nonda Bulka"
- Shkolla e mesme "Sami Frashëri"

32 % nga zonat rurale

- Shkolla "1 Maji", Njësia Administrative Piskovë
- Petran, Njësia Administrative Piskovë



51 përqind
e të rinjve të anketuar janë
vajza

FAKTE MBI TË RINJTË E PËRMETIT

A. NJOHURITË MBI OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT TË
QËNDRUESHËM (SUSTAINABLE DEVELOPMENT GOALS - SDGs)



1 në 7


të rinj kanë dëgjuar se çfarë janë SDGs

Ndërmjet të rinjve që kanë njohuri mbi SDGs rezulton se:

- a. **Interneti (33.5%) dhe shkolla (33.5%)** janë **burimi më i shpeshtë i informacionit** për të rinjtë në zonat urbane për pasurimin e njohurive të tyre mbi këtë çështje.
- b. **Institucionet lokale (50%)** janë **burimi më i shpeshtë i informacionit** për të rinjtë në zonat rurale.

Organizatat e shoqërisë civile janë gjithashtu burime për marrjen e informacionit mbi SDGs nga të rinjtë e zonave urbane dhe rurale. Interesant është fakti se të rinjtë e zonave urbane shprehen se informacionin për SDGs e marrin edhe nëpërmjet shkollës, ndërsa kjo gjë nuk është evidentuar në asnjë rast nga të rinjtë e zonave rurale.

Ndërsa familja në asnjë rast nuk është cituar si burim informacioni mbi SDGs nga të rinjtë e anketuar në zonat urbane dhe rurale.



ANGAZHIMI I TË RINJVE NË ARRITJEN E SDGs


Të rinjtë janë pyetur në lidhje me angazhimin personal dhe përfshirjen në aktivitete të ndryshme mbi SDGs.

Shumica e të rinjve të grupmoshave të ndryshme (**63% e rasteve**) janë shprehur se **nuk janë përfshirë personalisht në arritjen e SDGs**.

Vetëm 6% e të rinjve shprehen se janë përfshirë pjesërisht për arritjen e SDGs.

Një pjesë e konsiderueshme e të rinjve (31% e grupmoshave të ndryshme) shprehen se dëshirojnë të përfshihen, por nuk kanë informacionin e nevojshëm se si mund të ndodh kjo gjë.

Përqindja e të rinjve të përfshirë personalisht në arritjen e SDGs



Të rinjtë janë pyetur edhe mbi rolin që ata mendojnë se mund të kenë për arritjen e SDGs.



ROLI i të RINJVE në arritjen e SDGs *(sipas të rinjve të anketuar)*

- Informimi i të rinjve dhe shprehja e mendimeve të tyre;
- Angazhimi më i madh në shoqëri duke bërë më të fortë dhe të dëgjueshëm zërin e bashkëmoshatarëve të tjerë;
- Pjesëmarrja dhe përfshirja direkte e të rinjve për adresimin dhe lobimin mbi çështjet e tyre prioritare.

FAKTE MBITË RINJTË E PËRMETIT


B. NJOHURITË MBI SHËNDETIN SEKSUAL DHE RIPODHUES

Të rinjtë janë pyetur edhe mbi njohuritë e tyre në lidhje me shëndetin seksual dhe riprodhues.

Pjesa më e madhe e të rinjve të anketuar kanë marrë informacion mbi shëndetin seksual dhe riprodhues. Anketimi tregoi se **1 në 4** të rinj nuk kanë marrë ndonjëherë informacion mbi shëndetin seksual dhe riprodhues.

Shumica e të rinjve që kanë pohuar se nuk kanë marrë ndonjëherë informacion mbi shëndetin seksual dhe riprodhues i përkasin zonave urbane. Ndërsa midis të rinjve më të informuar janë vajzat në zonat urbane (37%), edhe të rinjtë më pak të informuar janë vajzat në zonat rurale (11%).


Përqindja e të rinjve që kanë marrë informacion mbi shëndetin seksual dhe riprodhues




Ndërmjet të rinjve që kanë njohuri mbi shëndetin seksual dhe riprodhues, **shkolla dhe interneti janë burimi më i shpeshtë i informacionit të përdorur** për pasurimin e njohurive të të rinjve mbi këtë çështje.

Ndërsa **shkolla, interneti, media dhe fletëpalosjet konsiderohen mjetet ideale për marrjen e informacionit** për shëndetin seksual dhe riprodhues nga ana e të rinjve.

Burimet e informacionit




Përqindja e të rinjve që i'u është folur në shkollë për:



Shumica e të rinjve (49%) shprehen se informacioni i marrë në shkollë mbi shëndetin seksual dhe riprodhues është pjesërisht i mjaftueshëm.

Interesante është rezultati mbi 23% e të rinjve në zonat urbane që shprehen se informacioni i marrë në shkollë mbi shëndetin seksual dhe riprodhues është i mjaftueshëm, përkundëjt 8% e të rinjve në zonat rurale.

Nga analiza gjinore rezulton se djemtë janë përgjigjur se informacioni i marrë në shkollë mbi shëndetin seksual dhe riprodhues është 'pjesërisht i mjaftueshëm' ose 'nuk kanë informacion'.




Nga anketimi i të rinjve në Përmet, rezultoi se shumica e tyre **(56% në zonat rurale dhe 29% në zonat urbane)** nuk flasin me prindërit e tyre mbi çështjet e shëndetit seksual dhe riprodhues.

Vetëm **16% e të rinjve të anketuar në zonat urbane** dhe **9% e të rinjve në zonat rurale** pohojnë se flasin me prindërit e tyre mbi çështjet e shëndetit seksual dhe riprodhues.

Në radhët e të rinjve që flasin mbi këtë tematikë, rezulton se 6% e të rinjve në zonat urbane dhe 6% e të rinjve në zonat rurale komunikojnë vetëm me babain, ndërsa një pjesë më e madhe preferojnë të komunikojnë vetëm me nënën.

Interesante është rezultati i **3% i të rinjve në zonat urbane që shprehen se prindërit nuk i lejojnë** të komunikojnë mbi shëndetin seksual dhe riprodhues në familjet e tyre. Kjo gjë është komunikuar nga vajzat e anketuara dhe sjell në vëmendje nevojën për ta adresuar këtë tematikë me prindërit.


A flisni për shëndetin riprodhues dhe seksual me prindërit tuaj?



FAKTE MBITË RINJTË E PËRMETIT

C. NJOHURITË MBI PROGRAMET DHE SHËRBIKET E BASHKISË PËR TË RINJTË

1 në 2 të rinj janë në dijeni të programeve/ prioriteteve të Bashkisë në lidhje me të rinjtë. Ndër të rinjtë që janë shprehur se janë në dijeni të programeve që ofron Bashkia e Përmetit për të rinjtë, pjesën më të madhe e zënë djemtë e anketuar në zonat rurale me 33%. Ndërsa djemtë nga zonat urbane janë më pak të informuar për programet dhe shërbimet që ka Bashkia për të rinjtë (në masën 13%).



Shumica e të rinjve (40% në zonat urbane dhe 28% në zonat rurale) shprehen se **nuk kanë marrë ndonjëherë** pjesë në takime që Bashkia ka zhvilluar me të rinjtë për përcaktimin e prioriteteve të zhvillimit të zonës, si dhe nuk janë në dijeni të këtyre takimeve.



34% e të rinjve nga zonat urbane dhe 34% e të rinjve nga zonat rurale janë shprehur se kanë marrë pjesë në takimet e organizuara nga Bashkia (Ndonjëherë ose shpesh). Ndërsa 7% e të rinjve në zonat urbane shprehen se marrin pjesë gjithmonë në takimet e Bashkisë.


Nga të rinjtë që janë informuar mbi programet e Bashkisë, rezulton se mjeti më i përdorur për marrjen e informacionit nga Bashkia janë:

a. Njoftimet publike (25%) - për të rinjtë në zonat rurale

b. Faqja zyrtare e Bashkisë (40%) – për të rinjtë në zonat urbane


Broshurat dhe portalet online mbeten gjithashtu mjete informuese të përdorura nga të rinjtë.

Ndërkohë kërkesat zyrtare drejtuar Bashkisë janë një instrument që përdoret shumë pak nga të rinjtë e anketuar të zonave urbane dhe rurale.




Aktivitetet promovuese dhe gjithë përfshirëse dhe takimet e vazhdueshme informuese dhe trajnimet janë programet më të preferuara që të rinjtë do të donin të përfitonin nga Bashkia e Përmetit. Gjithashtu të rinjtë kanë identifikuar si shërbime të preferuara edhe ofrimin e ambienteve sportive, punësimin, qendrën rinore, e-shërbimet si edhe ofrimin e bursave.

Përqindja e të rinjve që do të donin që Bashkia të ofronte shërbimet e mëposhtme për të rinjtë



20 % e të rinjve vlerësojnë shumë mirë ofrimin e shërbimeve administrative të Bashkisë në përputhje me nevojat e të rinjve, ndërsa 18% e të rinjve vlerësojnë maksimalisht ngritjen dhe funksionimin e zyrave me një ndalesë në Bashki.

Përqindja e të rinjve të cilët vlerësojnë me pikët më poshtë shërbimet që janë ofruar nga Bashkia për të rinjtë
(1- vlera më e vogël, 5- vlera më e madhe)



TË RINJTË BASHKIA E PËRMETIT



Leave
No One
Behind

